- e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Formulari i Ofertës ekonomike, për procedurat e prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët nga operatori ekonomik

Shtojca 3: Listat e Çmimeve të artikujve

Shtojca 4: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 5: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Sasisë dhe Grafikut i lëvrimit

Shtojca 8: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 9: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁴

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontratës;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

⁴ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

[Në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët, nga operatori ekonomik plotësohet dhe paraqitet vetëm kjo Shtojcë]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

ç) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës.

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute është si më poshtë:

1	2	3
Nr.	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute

Referuar Nenit 45, pika 2/1 e VKM Nr. 285, date 19.05.2021, i ndryshuar,

2.1. Për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, në rastet kur oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët, ky i fundit përllogaritet bazuar në:

a) çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date;

b) elementet fiskale;

c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës.

APP publikon çmimet e bursës së dërguar për publikim nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Kujdes: Bazuar në parashikimet e nenit 45/2.1 të VKM Nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, kur si kriter vlerësimi përdoret “oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët”, autoriteti/enti kontraktor përllogarit çmimin bazuar në:

a) çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date

b) elementet fiskale;

c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës;

Shtojca 3.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë** (në rast BOE): _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në këtë Formular duhet të plotësohen dhe t'u vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa vlerë do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

1	2	3	4	5	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njësi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.	Gaz i lëngët për gatim	86,244			
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					
Datë _____					

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së.*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e *[emri i autoritetit/entit kontraktor]* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në *[njoftimin e kontratës]*.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 5.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit**Nënshkrimi****Vula**

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

1. Specifikimet teknike.

- 1.1 Gazi i Lëngët (GLN) duhet të respektojë kërkesat e standardit evropian çertifikatën SSH EN 589:2018 + A1:2022 "Lëndë djegëse për përdorim shtëpiak dhe industrial GLN (Mishelë) i cili përmbush plotësisht kërkesat e cilësisë sipas tregut, sipas Drejtorisë së Standardizimeve.
- 1.2 Bombolat të plotësojnë kërkesat e sigurisë, të përcaktuara sipas rregullit teknik përkatës, përfshirë edhe pajisjen e tyre me **deklaratën e konformitetit**, si dhe me numrin e serisë. Bombola duhet të mbartë markimin përkatës, që demonstroi përputhshmërinë e saj me kërkesat e legjislacionit në fuqi për konformitetin.
- 1.3 Në sipërfaqen e bombolës duhet të pasqyrohen
 - të dhëna për markën tregtare të shoqërisë,
 - peshën neto dhe bruto, të shprehur në kilogram,
 - simbolin e flakës së ndezshme,
 - vitin e prodhimit,
 - datën e kontrollit teknik
 - udhëzimin për përdorim të sigurt të tyre.

-
- 1.4 Bombolat me të cilat do të transportohet GLN duhet të plotësojnë standardet e kërkuara nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial.
 - 1.5 Bombolat duhet të jenë të testuara edhe për mos-shpërthimin e tyre në rast zjarri.
 - 1.6 Ambalazhimi i gazit duhet të bëhet në bombola me kapacitet jo më shumë se 15-30 kg.
 - 1.7 Bombolat duhet të jenë të pajisura me skedat teknike.
 - 1.8 Bombolat duhet të kenë të stampuar në trup treguesit e vëllimit të enës, peshës bosh të saj, si dhe datën kur është prodhuar.
 - 1.9 Bombolat duhet të kenë të stampuar në trup një numër serie me jo më pak se 6 shifra, në mënyrë që të jenë të identifikueshme nga njera-tjetra.

Argumentim për hartimin e specifikimeve teknike:

Për hartimin e specifikimeve teknike të Gazit të Lëngët për gatim komisioni i është referuar:

- *Kërkesa e vendosur në specifikimet teknike që “Gazi i Lëngët (GLN) plotëson kërkesat e standardit evropian S SH EN 589:2018 + A1:2022 “Lëndë djegëse për përdorim shtëpiak dhe industrial GLN (Mishelë)” mbështetet në VKM Nr. 429, datë 26.06.2019, “Për cilësinë e disa lëndëve të djegshme, të lëngëta, për përdorim termik, civil e industrial, si dhe përdorim në mjetet e transportit ujor (detar, lumor dhe liqenor)”.*
- *Ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për Përpunimin, për Transportin dhe Tregtimin e Naftës, të Gazit dhe nënprodukteve të tyre, i ndryshuar”,*
- *Vendimit Nr. 212 datë 16.03.2016 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kushteve dhe të rregullave teknike për përpunimin e bombolave të mbushura me gaz të lëngëzuar të naftës GLN”,*
- *Ligjit 10489/2011 “Për mbikëqyrjen e tregut të produkteve jo-ushqimore”, i ndryshuar,*
- *VKM nr. 1047 datë 16.07.2008 “Per disa ndryshime dhe shtesa ne Vendimin nr. 170 date 25.04.2002 te Keshillit te Ministrave “Per pecaktimin e procedurave dhe kushteve per dhenien e lejeve dhe te autorizimeve, per tregtimin e naftes, gazit e nenprodukteve te tyre”, te ndryshuar,*
- *Ligjin nr. Nr.9902, datë 17.4.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”,*
- *Ligjit nr. 32/2016 “Për sigurinë e punës të paisjeve dhe instalimeve nën presion”,*
- *Urdhrin nr. 128, date 08.04.2016 “Për miratimin e procedurave për kontrollin teknik të vlerësimit të konformitetit të bombolave të GLN”*

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Sasia e mallit që kërkohet: **86 244 kg.**

Grafiku i lëvrimit do të jetë sipas kërkesave të AK, në varësi të nevojave të kopshteve dhe çerdheve.

Afatet e lëvrimit: sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor duke filluar nga nënshkrimi i kontratës deri në përfundim të periudhës 12 mujore të MK.

Kushtet e Lëvrimit të Produktit “Gaz i Lëngët”.

1. Porositë e gazit do t'i jepen operatorit furnizues gjatë javës me telefon nga Sektori i Planifikimit dhe Administrimit të DPÇK. E shtuna dhe e diela dhe festat zyrtare janë pushim.
2. Bombolat e porositura nga Sektori i Planifikimit dhe Administrimit duhet të vijnë në magazinën e DPÇK me autojmetet e operatorit furnizues brenda orës 10.⁰⁰
3. Me ardhjen e bombolave të porositura, Komisioni i Pritjes së Gazit të Lëngët, do të kryejë verifikimin e cilësisë në bazë të specifikimeve teknike, verifikimin e numrave serialë të bombolave sipas faturave provizore shoqeruese të operatorit furnizues, si dhe do të verifikojë sasinë e gazit të ardhur duke peshuar çdo bombul.
4. Bombolat duhet të jenë me një kapacitet mbajtës jo më shumë se 15-30 kg gaz të lëngët
5. Pas procedurave të mësipërme, bombolat e gazit do të shpërndahen nëpër çerdhet dhe kopshtet me automjetet e operatorit furnizues duke u shoqëruar nga një punonjës i caktuar si kontrollor nga DPÇK, deri në dorëzimin dhe vendosjen (montimin) e bombolës në vendin e duhur nga punonjësi i subjektit kontraktor i cili është i pajisur me çertifikate profesionale të vlefshme për instalimin e bombolave të gazit.
6. Operatori furnizues duhet t'i dorëzojë çdo kopshti apo çerdhje nga 2 deri në 5 bombola të cilat merren në dorëzim nga drejtoresha, kuzhinierja dhe nd/kuzhinierja.
7. Montimi dhe çmontimi i bombolave është detyrë e operatorit furnizues për t'i ndërruar ato.
8. Operatori furnizues pas lidhjes së kontratës është i detyruar të ndërrojë reduktorët dhe tubat e presionit nga bombola deri tek soba e gatimit, në të gjitha kopshtet dhe çerdhet publike të cilat përdorin soba me gaz, sipas nevojave që kanë. Operatori është përgjegjës për rregullimin dhe mirëmbajtjen e këtyre aksesoreve.
9. Shpërndarja e bombolave të gazit dhe kostoja e transportit deri në Kopshte dhe Çerdhe do të mbulohet nga Operatori Ekonomik.

Shtojca 8.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

OFERTUESI DEKLARON SE:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Vërtetim nga organet tatimore, për xhiron vjetore për 3 vitet e fundit financiare 2022, 2023, 2024 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % të vlerës limit të kontratës që prokurohet.

2.3 Kapaciteti teknik:

-
- 2.3.1. Operatori Ekonomik duhet te paraqese deshmi per furnizimet e meparshme, te ngjashme, te kryera gjate 3 (tre) viteve te fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës ne nje vlere jo me te vogel se 40% e vleres se perllogaritur te kontrates, qe prokurohet dhe qe eshte realizuar gjate tre viteve te fundit.
- Operatori ekonomik per te vertetuar pervojen e meparshme te realizuar me sektorin publik, duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat, sasi të dhe llojin e mallrave të furnizuara.
 - Operatori Ekonomik per te vertetuar përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat, sasi të dhe llojin e mallrave të furnizuara.
- 2.3.2. Operatori Ekonomik duhet te paraqese **Deklaratë Konformiteti CE** të lëshuar nga prodhuesi për bombolat e gazit që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me ligjet e parashikuara në Republikën e Shqipërisë dhe specifikimet teknike të përcaktuara në DST.
- 2.3.3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokument **“Vërtetim përputhshmërie”** për bombolat e gazit, të lëshuar nga një organ i miratuar/notifikuar i vlerësimit të konformitetit.
- 2.3.4. Operatori ekonomik duhet te paraqesë **fletë analizën e vlefshme te gazit**, lëshuar nga një laborator i certifikuar ne Republikën e Shqipërisë.
- 2.3.5. Operatori Ekonomik **duhet të paraqesë autorizimin/liçensë per tregtimin e bombolave te GLN per përdorim rezidencial.**
- 2.3.6. Operatori ekonomik duhet te paraqes vetdeklarim sipas shtojcës 9 të DST, Formulari Përmbledhës i Vetdeklarimit, ku te deklaroje se disponon jo me pak se **3 punonjës** të cilët janë të pajisur me **Çertifikate Profesionale** të vlefshme per instalimin e bombolave te gazit, te leshuara nga institucionet perkatese shteterore apo subjekte private te liçensuara per kete aktivitet të cilët do të jenë përgjegjës për instalimin e bombolave.
Operatori ekonomik i klasifikuar i pari, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit** duhet të paraqesë Certifikatat profesionale të punonjesve të deklaruar.
- 2.3.7. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vetdeklarimin sipas shtojcës 9 të DST, Formulari Përmbledhës i Vetdeklarimit, ku të deklarojë se disponon **3 (tre) automjete transporti me masë maksimale të autorizuar jo më shumë se 3.5 ton, të pajisur me Certifikatën ADR (për transportin e lëndëve të**

rrezikshme), ne pronësi ose ne perdorim, në momentin e deklarimit si dhe përgjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës marrëveshje kuadër.

Operatori ekonomik i klasifikuar i pari, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit**, duhet të paraqesë dokumentacionin që disponon 3 (tre) automjetet ne pronësi ose ne perdorim sipas kontrates noteriale, te vertetuar me:

- leje qarkullimi,
- çertifikate pronësie
- siguracion (TPL)
- çertifikatë e kontrollit teknik
- Çertifikatën ADR(Per transportin e lendeve te rrezikshme).

2.3.8. Operatori Ekonomik duhet te paraqesë **“Policën e Sigurimit”** me te cilen merr persiper shperblimin e demit te shkaktuar nga defektet qe mund te vijnë nga përdorimi i gazit të lëngët.

2.3.9. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë **deklarate** në bazë të të cilët duhet marrë përsipër instalimin e bombolave të gazit në ambientet e çerdheve dhe kopshteve si dhe duhet **të deklarojë** se ka të gjitha kapacitete për ndërhyrje urgjente nga personat e pajisur me çertifikate profesionale në rastet emergjente kur paraqitet avari, rrezik rrjedhje gazi, etj.

2.3.10. Operatori ekonomik duhet të disponojë çertifikatën **ISO 9001:2015**, lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë ose ekuivalente me të, të vlefshme, e cila të përfshijë objektin e prokurimit.

2.3.11. Operatori ekonomik duhet të disponojë çertifikatën **ISO 14001:2015** për sistemin e menaxhimit të mjedisit, ose ekuivalente me të, të vlefshme, e cila të përfshijë objektin e prokurimit.

2.3.12. Operatori ekonomik duhet te paraqes nje moster (bombol me gaz) sipas specifikimeve teknike te Autoritetit Kontraktor per artikullin e kerkuar.

Mostra (bombol me gaz) do të paraqitet ne daten dhe oren e hapjes se ofertave, prane DPÇK me adrese “Rr. e Barrikadave, Çerdhja nr. 1 Tirane”.

Mostra e kerkuar (bombola me gaz) duhet te kete etiketë e cila te permbaje përshkrimin:

- *Moster “emri i artikullit”,*
- *Daten e zhvillimit te tenderit,*
- *Emrin e ofertuesit,*
- *Nënshkrimin dhe Vulen e operatorit ekonomik*

Në sipërfaqen e bombolës duhet të pasqyrohen:

- *të dhëna për markën tregtare të shoqërisë së tregëtimit të bombolës.*
- *peshën neto dhe bruto të bombolës, të shprehur në kilogram,*
- *simbolin e flakës së ndezëshme,*
- *vitin e prodhimit të bombolës*
- *datën e kontrollit teknik të bombolës*
- *udhëzimin për përdorim të sigurtë të tyre.*

Mungesa e mostrës është kusht skualifikues.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

I gjithë dokumentacioni i kërkuar nëse është në gjuhën shqipe duhet të paraqitet në origjinal ose kopje e noterizuar e njësuar me origjinalin. Nëse dokumenti është në gjuhë të huaj, duhet të paraqitet i përkthyer nga një përkthyes i licensuar, shoqëruar me vërtetim përkthimi nga Noteri, si dhe i noterizuar e njësuar kopja me origjinalin nga Noteri.

Mosparaqitja e dokumentacionit të kërkuar, ose paraqitja e dokumentave të rreme, përbën kusht për skualifikim.

Argumentim mbi hartimin e e kriterëve teknike për kualifikim

Për hartimin e kriterëve teknike për kualifikim, komisioni i është referuar:

- Kërkesa që OE duhet të paraqesë Deklaratë Konformiteti CE të lëshuar nga prodhuesi është vendosur në zbatim të kërkesave që përcaktohen në Ligjin nr. 32/2016 “Për garantimin e sigurisë së punës të paisjeve dhe instalimeve nën presion”, Neni 6, Pika 1, ku citohet: Çdo pajisje/instalim nën presion, përpara hedhjes në treg dhe vënies në shfrytëzim, duhet të shoqërohet me deklaratën e konformitetit CE, të lëshuar nga prodhuesi, ku përfshihet edhe procedura e vlerësimit të konformitetit për fazën e shfrytëzimit, sipas moduleve apo rregullave teknike përkatëse, VKM nr. 212, datë 16.03.2016 “Për përcaktimin e kushteve dhe rregullave teknike për përpunimin e bombolave të gazit të mbushura me gaz të lëngshëm të naftës GLN. Pika III.1 ku përcaktohet: “Tregtimi me shumicë i GLN-së, nëpërmjet bombolave, bëhet nga shoqëritë e tregtimit me shumicë, me kusht që këto bombola të plotësojnë kërkesat të sigurisë, të përcaktuara sipas rregullit teknik përkatës, përfshirë edhe pajisjen e tyre me deklaratën e konformitetit, për të gjithë sasinë e prodhuar dhe të importuar, si dhe me numrin e serisë. Bombola duhet të mbartë markimin përkatës, që demonstroi përputhshmërinë e saj me kërkesat e legjislacionit në fuqi për konformitetin”.

- Kërkesa që OE duhet të paraqesë dokument “Vërtetim përputhshmërie” për bombulat e gazit, të lëshuar nga një organ i miratuar/notifikuar i vlerësimit të konformitetit është vendosur në zbatim të kërkesave që përcaktohen në Ligjin nr. 32/2016 “Për garantimin e sigurisë së punës të paisjeve dhe instalimeve nën presion”, Neni 4, Pika 3; 4; 5 ku përcaktohet:

Pika 3. Përpara fillimit të procedurës së montimit të pajisjes/instalimit nën presion, operatorët ekonomikë marrin masa për vlerësimin e konformitetit të tij, nga një organ i miratuar/notifikuar për vlerësimin e konformitetit, në përputhje me rregullat teknike përkatëse.

Pika 4. Organi i miratuar/notifikuar i vlerësimit të konformitetit shqyrton përputhshmërinë e projektit të paraqitur me rregullat teknike përkatëse dhe, nëse e gjen në përputhje me to, lëshon vërtetimin e përputhshmërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore.

Pika 5. Inspektorati shtetëror përgjegjës mbikëqyr zbatimin e këtij detyrimi nga operatorët ekonomikë përkatës, në përputhje me legjislacionin në fuqi për inspektimin.

- Kërkesa që OE duhet të paraqesë fletë analizën e vlefshme të gazit, lëshuar nga një laborator i certifikuar në Republikën e Shqipërisë është vendosur në zbatim të Ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për Përpunimin, për Transportin dhe Tregtimin e Naftës, të Gazit dhe nënprodukteve të tyre, i ndryshuar”, Urdhërit nr. 6 datë 09.01.2015 të Ministrisë së Energjisë dhe Turizmit “Për kontrollin dhe standardet teknike të naftës dhe nënprodukteve të saj.....” Pika I ku përcaktohet: Kontrolli i cilësisë së naftës dhe nënprodukteve të saj bëhet në zbatim të VKM nr.147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse, benzine dhe diesel”, të VKM nr. 781, datë 14.11.2012 “Për cilësinë e disa lëndëve të djegshme, të lëngshme, për përdorim termik, civil e industrial, si dhe për përdorim në mjetet e transportit ujor (detar, lumor dhe liqenor)” dhe të metodikave të testimit të standardeve përkatës në fuqi, të miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimeve, në Laboratorin e akredituar të Inspektoratit Shtetëror Përgjegjës (ISHP) ose në laboratorë të tjerë të akredituar”.

- Kërkesat për autorizimin/liçensë për tregtimin e bombolave të GLN për përdorim rezidencial, është vendosur në zbatim të ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999 i ndryshuar, kreu 2, neni 11, shkronja d), Vendimit Nr. 212 datë 16.3.2016 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kushteve dhe të rregullave teknike për përpunimin e bombolave të mbushura me gaz të lëngëzuar të naftës GLN”, ligjit 10489/2011 “Për mbikëqyrjen e tregut të produkteve jo-ushqimore”, i ndryshuar, VKM nr. 1047 datë 16.07.2008 Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 170 datë 25.04.2002 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhenien e lejeve dhe të autorizimeve, për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar.

- Kërkesa që OE duhet të ketë jo më pak se 3 punonjës të cilët janë të pajisur me Çertifikate Profesionale të vlefshme për instalimin e bombolave të gazit, të lëshuara nga institucionet perkatese shtetërore apo subjekte private të liçensuara për këto aktivitet është vendosur pasi ata do të jenë përgjegjës për instalimin e bombolave pranë çerdheve dhe Kopshteve të Bashkisë Tiranë.

- Kërkesa që OE duhet të disponojë disponon 3 (tre) automjete transporti me masë maksimale të autorizuar jo më shumë se 3.5 ton, të pajisur me Certifikatën ADR (për transportin e lëndëve të rrezikshme), , është vendosur dike patur parasysh nevojat e AK për gaz të lëngët, në zbatim të kërkesave për furnizimin e 42 kopshteve dhe 46 çerdheve, duke patur parasysh dhe shpërndarjen e tyre gjeografike në gjithë qytetin e Tiranës si dhe në zbatim të Ligjit nr. 118/2012 “Për transportin e mallrave të rrezikshme”. Kërkesa për masën maksimale të autorizuar është vendosur sipas orinetimeve të APP datë 07.04.2023, me qëllim shmangien e konfuzionit në përgatitjen e ofertave nga OE, si dhe të KVO në vlerësimin e tyre

- Kërkesa që OE duhet të paraqesë “Policën e Sigurimit” me të cilën merr persipër shpërblimin e demit të shkaktuar nga defektet që mund të vijnë nga përdorimi i gazit të lëngët është vendosur në zbatim të VKM nr. 212, datë 16.03.2016 “Për përcaktimin e kushteve dhe rregullave teknike për përpunimin e bombolave të gazit të mbushura me gaz të lëngshëm të naftës GLN, Kreu 6, Pika 8, ku përcaktohet: “Konsumatori jofamiljar që përdor bombol të mbushur me GLN, duhet të jetë i pajisur me një kontratë sigurimi me një shoqëri sigurimesh, për të garantuar rimbursimin e dëmeve të shkaktuara ndaj palëve të treta, në rast aksidenti prej këtyre sistemeve dhe bombolave të GLN-së.

- Kërkesa që OE duhet marrë përsipër instalimin e bombolave të gazit në ambientet e çerdheve dhe kopshteve si dhe duhet të deklarojë se ka të gjitha kapacitete për ndërhyrje urgjente nga personat e pajisur me certifikate profesionale në rastet emergjente kur paraqitet avari, rrezik rrjedhje gazi, etj. është vendosur në zbatim të VKM nr. 212, datë 16.03.2016 “Për përcaktimin e kushteve dhe rregullave teknike për përpunimin e bombolave të gazit të mbushura me gaz të lëngshëm të naftës GLN, Kreu 6, pika 5 ku përcaktohet: “Shoqëritë e tregtimit me pakicë duhet të ofrojnë edhe shërbimin e mirëmbajtjes së instalimeve të bombolave me GLN”.

- Kërkesa që OE duhet të disponojë certifikatën ISO 9001:2015, është vendosur për të siguruar që OE plotëson standardet e kërkuar në lidhje me sistemin e menaxhimit të cilësisë.

- Kërkesa që OE duhet të disponojë certifikatën ISO 14001:2015 është vendosur për të siguruar që OE plotëson standardet e kërkuar në lidhje për sistemin e menaxhimit të mjedisit.

- Kërkesa për të dhenat e kërkuar për mostrën e paraqitur janë vendosur në zbatim të Ligjit nr. Nr. 71/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, neni 7, pika 5 ku përcaktohet që: “Shoqëritë e tregtimit me shumicë të gazit të lëngshëm të naftës përgjigjen për kryerjen e kontrollit teknik dhe mbushjen e bombolave me GLN. Shoqëritë e tregtimit me shumicë, përpara futjes së bombolave në treg, bëjnë evidentimin e tyre për markën tregtare të shoqërisë, peshën neto, peshën bruto, vitin e prodhimit, datën e kontrollit teknik, si dhe udhëzimin për përdorim të sigurt të tyre”.

Për përlogaritjen e fondit limit AK është bazuar në:

- Tavanin Buxhetor të miratuar nga Bashkia Tiranë për DPÇK për vitin 2025 art. 602 sipas VKB nr.131 datë 18.12.2024 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 dhe detajimin e buxhetit të BT për vitin 2025”, si dhe planit të miratuar të detajimit të art. 602 të vitit 2025 me shkresën nga BT nr.6426 prot, datë 05.02.2025.
- Procesverbalin e Testimit të tregut, si dhe ofertave të tregut bashkëlidhur procesverbalit.

Shtojca 9.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- ---

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Informacione për nënkontraktorin
--

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT – i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë (Emër, mbiemër, Nr. ID): etj. nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv). <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____

Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Në cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, **Deklaroj Se:**

Jam në dijeni të pasojave që vinë ndaj meje lidhur me këtë Deklaratë, në respektim të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Kam përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur, pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër⁶.

Në veçanti, pa kufizuar si më lart, nuk kam pasur kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me:

- a) çmimet;
- b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
- c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
- d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

Nuk kam pasur marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent, me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë.

Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t’u bëhen të njohura, me qëllim cënimin e konkurrencës, në çdo mënyrë qoftë, konkurrentëve të tjerë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj.

⁶ Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që: a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor; b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon: Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.
